# KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, neneve 6.2 dhe 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 të datës 27.12.2006, dhe nenit 15.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2015, miratoi,

## VENDIM
## PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

**Neni 1**
Sadik Jakup Syla nga fshati Gllamnik Komuna e Podujevës, në cilësinë e pronarit, i lejohet ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar sipas ngastrave kadastrale nr. 1690-2 dhe 1690-3 kultura – bujqësore - arë kl. 4 vendi i quajtur Lahevit Ara dhe në sipërfaqe prej 1000 m², certifikata pronësore nr. 08/095/82277/15 të datës 16.09.2015, Zona kadastrale Gllamnik.

**Neni 2**
Pronari, në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që paluajtshmërinë përkatëse ta shfrytëzojë vetëm për ndërtimin të objektit - fermë dhe nuk mund ta përdorë për qëllime të tjera.

**Neni 3**
Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

**Neni 4**
Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Neni 5**
Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

**Neni 6**
Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

**Nr. 01-006-86594**
**Podujevë,**
**30 shtator 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Mehmet Gashi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO
PODUJEVË

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE/ MINISTARSTVO JAVNIH SLUZBI/ MINSTRY OF PUBLIC SERVICES

**KUVENDI KOMUNAL SKUPSTINA OPSTINA MUNICIPALITY**

**P O D U J E V Ë-O**

# KOPJE PLANI-A

**ZA GEOD.KAT.I SVOI/DEP FOR GEO.CADA&PROPERTY**

Z.Kadastrale/K .Zona/Municipal Zon Gllamnik Shk.Zv/Razmera/Apr .Gra: P=1: 1000

Pronari/Posednik/Possesion Syla Sadik (Jakup)1/1 Gllamnik

Fleta posed /Posedovni list/Possession list nr:____ Plani/Plan/Plan_____ Skica/Skica/Sketch nr______




08-035-82277/82297

NR rend I taksave/Redni br.takes/Nomber takse Ësht kopje e origji. të vitit/ Kopja orgin stanj god./Original kopy yers___

| Ngastra Parcela Parcel | Kultura Kultura Cultu. name | Klasa Klasa Class | Vendi I quajtur Zvano mesto Place name | Sip/Pove/Area ha | ar | m | Vërejtje Napomena Notice |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1690-2 | Arë | 4 | Lahevit Ara | 0 | 05 | 95 | |
| 1690-3 | " | " | " | 0 | 04 | 05 | |
| | | | Gjithsejt | 0 | 10 | 00 | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

Podujevë-o 16/09/ 2015Punoi/Izradio/Working______ Drejtori /Direktor/Director Abaz Llugaliu